

VENDIM
Nr. 341, datë 21.12.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “BALKAN ENERGY TRADE” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2094 prot., datë 19.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Balkan Energy Trade’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 319, datë 12.12.2022, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria, me *e-mail*-in e datës 13.12.2022, protokolluar në ERE me nr. 2015/1, datë 14.12.2022, ka përcjellë pjesërisht dokumentacion që lidhet me këtë aplikim.

- ERE me shkresën nr. 2015/2 prot., datë 15.12.2022, ka njoftuar shoqërinë për mosfillimin e procedurës, duke evidentuar edhe dokumentacionin e munguar dhe, po ashtu, ka bërë me dije se në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në rast se, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, shoqëria paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit, licencimit në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, në zbatim të aneksi A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Balkan Energy Trade” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin si vijon:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1.1 germat “a”, “b”, “c”: plotësuar;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 1.2, germat “a”, “c”, “d”: plotësuar;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 1.3, germa “a” dhe “c”: plotësuar;

- Dokumentacioni specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 2.5: plotësuar;

- Nga ky aplikim rezultojnë mungesa në dokumentacionin, si më poshtë:

Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”

- germa “b”: Aplikuesi nuk ka përcjellë vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) për vetë shoqërinë dhe administratorin e saj.

Pika 1.3 “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”

- germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE balancat aktive që disponon në llogarinë bankare.

- Për dokumentacionin e kërkuar do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti